



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 77-të, të mbajtur më 14.11.2022, morri vendimin vijues:

#### VENDIM

Denoncimi me numër 12-7051/1 i datës 19.07.2022, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës. denoncimi të dërgohet për veprim kompetent në Drejtorinë e Policisë Financiare të RMV-së.

Lënda me numër 12-7051 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

#### Arsyetim

Lënda me numër 12-7051/1 të datës 19.07.2022 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Pretendimet e paraqitura në denoncim i referohen dyshimeve për sjellje të pakujdesshme dhe shpërdorim të pozitës dhe kompetencave zyrtare nga zyrtari ///, drejtor i ///, Komuna ///, si dhe për shkak të përfundimit të paligjshëm të një cedimi në bazë të dy kontratave për prokurimin publik. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, u dorëzuan edhe prova.

Nga mbikëqyrja në përmbajtjen e denoncimit dhe provave të dorëzuara , KSHPK-ja vlerësoi se lënda nuk elemente për veprim kompetent. Autoriteti kompetent që është i autorizuar për të hetuar dyshimet është Drejtoria e Policisë Financiare të RMV-së, prandaj KSHPK-ja e konsideroi të nevojshme që denoncimin me provat t'ia përcjellë këtij autoriteti.

Bazuar në të theksuarën sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:  
Arkivi i KSHPK -së

Përgaditi: Mr D. D.  
Miratoi: Mr.Sh. S.

КОМИСИОНИ СХТЕТЌОРОЌ  
ПЃР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ  
Kryetare,  
Biljana Ivanovska

